

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5800
E enjte, 13 qershor 2019
çmimi 0.40 €

REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR
20-VJETORIN E ÇLIRIMIT ■ FAQE 4-5

KOSOVA U ËSHTË FALËNDERUESE MIQVE TË LIRISË

Albrighti dhe Clarku
nderohen me
'Urdhrin e Lirisë' ■ FAQE 3



Ish-presidenti amerikan Bill Clinton dhe ish-sekretarja e shtetit Madeleine Albright janë pritur si heronj të mërkurën në Prishtinë. Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, mijëra qytetarë kishin dalë për



t'u shprehur mirënjohje dhe për t'i falënderuar zyrtarët e lartë amerikanë, të cilët para dy dekadave kishin vendosur për bombardimin e NATO-s mbi



ish-Jugosllavinë. Clintoni dhe Albrighti janë shprehur krenarë që vendimi i tyre ka ndalur spastrimin etnik të shqiptarëve nga forcat serbe. Me rastin e 20-vjetorit të çlirimit është bërë edhe zbulimi i bustit të ish-sekretares Albright

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

20-VJETORI
I ÇLIRIMIT,
POR
DREJTËSIA E
HESHTUR! ■ F. 11



Salihe SALIHU, PhD kandidat
dhe veprimtare

AKTUALE

MERREN MASA PËR
SHKELËSIT E RREGULLAVE
GJATË MBAJTJES SË
PROVIMIT TË MATURËS
SHTETËRORE ■ F. 6

MBAHET PUNËTORIA PËR
PËRMIRËSIMIN E
SHËNDETIT TË GRAVE DHE
FËMIJËVE NË KOSOVË ■ F. 6

EKONOMI

INSTITUCIONET PUBLIKO-
PRIVATE KANË NEVOJË PËR
SHËRBIMET E KONSULENCËS
■ F. 9

AKP-ja SHPALLI REZULTATET E
SHITJEVE PËRMES LIKUIDIMIT
NR. 47 ■ F. 9

KULTURË

NË PRIZREN VAZHDOJNË
RRËNIMET E NDËRTESAVE
ME VLERË TË TRASHËGIMISË
KULTURORE ■ F. 10

SPORT

FC PRISHTINA
VAZHDON
PËRGATITJET
PËR LIGËN E
EVROPËS NË
PEJË ■ F. 16



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Holanda u thotë jo negociatave për Shqipërinë

HAGË, 12 QERSHOR - Parlamenti i Holandës ka vendosur t'i thotë "Jo" Shqipërisë për hapje negociatash, ndërsa i ka thënë "Po" Maqedonisë së Veriut. Vendimi është marrë nga parlamenti të mërkurën në mbrëmje, ndërsa i rekomandohet Komisionit Evropian të mos hapë negociatat. Si shkak kryesor bëhet me dije është mosarritja e rezultateve në luftën ndaj korrupsionit të

organizuar dhe korrupsionit. Vendimi i marrë nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe Këshilli i Punëve të Jashtme të Holandës: "Propozuar më 11 qershor 2019, pas dëgjimit të diskutimit, duke vënë në dukje se, sipas Qeverisë holandeze, Shqipëria nuk po arrin rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar; vëren se në bazë

të këtij raporti të progresit mund të vërtetohet se Shqipëria nuk i plotëson kushtet e vendosura; i bën thirrje Qeverisë holandeze të mos pajtohet me propozimin e Komisionit për fillimin e negociatave për pranimin në BE", thuhet në vendimin që e mori Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme dhe Këshilli i Punëve të Jashtme të Holandës.



Meta nis konsultimet për datën e re të zgjedhjeve vendore

Presidenti Ilir Meta të mërkurën vendosi ta hapë procesin e konsultimeve për të caktuar një datë të re për zgjedhjet vendore.

Takimi i parë i konsultimeve do të nisë me partitë e grupimit të qendrës së djathtë që përfshin drejtuesit e partive të vogla aleate të demokratëve



TIRANË, 12 QERSHOR - Presidenti Ilir Meta pritet t'i nisë të mërkurën në mbrëmje konsultimet për datën e zgjedhjeve vendore, pas dekretit të firmosur dy ditë më parë për anulimin e 30 qershorit. Procesi që kreu i Shtetit po hap, pason reagimin e shumicës e cila nuk e njeh si të vlefshëm aktin e tij dhe këmbëngul për mbajtjen e zgjedhjeve në datën e paracaktuar.

Presidenti Ilir Meta bëri të mërkurën një tjetër lëvizje të papritur, ndërsa vendosi ta hapë procesin e konsultimeve për të caktuar një datë të re për zgjedhjet vendore. Një ditë më

parë ai ftoi partitë politike që "ta shfrytëzojnë këtë hapësirë kohore që u kam ofruar për gjetjen një zgjidhjeje urgjente për krizën, përfshirë pajtimin e një date të re për pjesëmarrjen e të gjithëve në zgjedhjet vendore".

Mbetet e paqartë pse presidenti po nxiton për datën, ndërkohë që mes palëve as që ka shenja për dialog e jo më të pajtohen për datën e zgjedhjeve, të cilën

ai vetë e ka parë si pjesë integrale të një marrëveshje të mundshme.

Socialistët po vijojnë aktivitetet duke pasur si kalendar 30 qershorin, sikundër dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili e konsideroi dekretin e kreu të Shtetit si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, ka njoftuar voa.

Nga ana tjetër, demokratët kanë bërë të qartë se përpara se të

flitet për datë, duhet që kryeministri Rama të ketë lënë detyrën. Ata i qëndrojnë vendimit të tyre për të mos lejuar mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor. Dhe të martën, Këshilli Kombëtar vendosi ngritjen në të gjithë vendin të Aleancës qytetare për mbrojtjen e demokracisë, e cila do të angazhohet për marrjen e të gjitha masave për ta mbrojtur rendin demokratik dhe kushtetues.

Takimi i parë i konsultimeve do të nisë me partitë e grupimit të qendrës së djathtë që përfshin drejtuesit e partive të vogla aleate të demokratëve. Socialistët dhe Partia Demokratike bën të ditur se nuk kanë marrë ndonjë njoftim nga Presidencia. Burime pranë PD-së shpjeguan se, megjithatë, në momentin që do të kenë një ftesë ata do të shkojnë në takim me presidentin Meta.

Zaevi takon Merkelin

SHKUP, 12 QERSHOR - Kryeministri i Maqedonisë Veriore, Zoran Zaev, ka udhëtuar për në Gjermani, ku sot (e enjte) do të takohet me kancelaren Angela Merkel, nga e cila pret përgjigje të qartë nëse Shkupi do të marrë ose jo datën e nisjes së negociatave të anëtarësimit me BE-në. Zaevi para nisjes për në Berlin ka thënë se mosmarrja e datës mund të ketë pasoja për shkak të mundësisë së përfshirjes së ndonjë pale të tretë

në rajon, por pa specifikuar se për cilin shtet e ka fjalën. "Nëse nuk japin datën Maqedonisë së Veriut mund ta hapin rrugën e ndikimit të shteteve të treta. Nëse nuk jepet data mos prisni t'i motivoni Vuçiqin dhe Thaçin të kërkojnë dialog për Kosovën, pasi nuk kanë motivim. Nëse nuk jepet data dot'i demotivoni proceset reformuese që kanë nisur apo ato ekonomike. Nëse nuk jepet data, përfundimisht mund ta kthejnë

nacionalizimin, radikalizmin, populizmin që nuk sjellin përparim. Pra, mosdhënia e datës mund të hapë shumë çështje, prandaj besoj se këto janë arsyet për ta caktuar datën e nisjes së bisedimeve", theksoi Zoran Zaev. Kreu i qeverisë thotë se mosaktimi i datës në kohën kur Maqedonia e Veriut ka marrë raportin më pozitiv deri më tani, me rekomandimin për nisjen e bisedimeve, do të ishte goditje për

institucionet dhe vendin, para së gjithash, për shkak të mbylljes së një për çështjeve më të ndjeshme, atë të ndërrimit të emrit. "Ne kemi të drejtë të plotë që të luftojmë për atë që e meritojmë dhe këtë do ta bëjmë deri në fund. Unë jam i bindur se do ta marrim datën e bisedimeve, por duam që këtë ta marrim sa më shpejt që të jetë e mundur. Këtë e duam këtë verë. E kuptoj se pse nuk do të jetë në qershor, por nuk e kuptoj pse jo në



korrik, prandaj dua të ma thonë dhe besoj se do ta marr përgjigjen. 14 vjet po presim datën për nisjen e bisedimeve, 14 vjet kemi pritur për shkak të problemit me Greqinë. E kemi merituar si asnjëherë më parë", deklaroi kryeministri Zoran Zaev.

Liderët shtetërorë kanë pritur në takime të ndara ish-sekretaren amerikane të shtetit, Madeleine Albright dhe ish-komandantin e NATO-s, gjeneralin Wesley Clark

Albrighti dhe Clarki nderohen me 'Urdhrin e Lirisë'

Ish-sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright dhe ish-komandanti i NATO-s, gjenerali Wesley Clark, janë nderuar të mërkurën në Prishtinë me "Urdhrin e Lirisë", për kontributin e dhënë për çlirimin e Kosovës. Ata kanë qëndruar për vizitë në Kosovë me rastin e 20-vjetorit të hyrjes së NATO-s. Albright dhe Clark janë pritur në takime të ndara nga liderët shtetërorë, me ç'rast është vlerësuar lart roli i tyre për lirinë dhe shtetin e Kosovës. Një ditë me parë me "Urdhrin e Lirisë" është nderuar edhe ish-presidenti i ShBA-së, Bill Clinton

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Për kontributin e dhënë në çlirimin e Kosovës të mërkurën janë nderuar me "Urdhrin e Lirisë" ish-sekretarja amerikane e shtetit, Madeleine Albright dhe ish-komandanti i NATO-s, gjenerali Wesley Clark, nga presidenti i vendit Hashim Thaçi. Me këtë rast, presidenti Thaçi ka thënë se ish-sekretarja e ShBA-së, Madeline Albright, me këmbëngulësinë e saj bashkoi dhe mobilizoi krejt botën për ta ndaluar spastrimin etnik në Kosovë. "Ish-sekretarja e SHBA-së, Madeleine Albright, me

sekretaren amerikane Madeleine Albright, të cilën e ka falënderuar për gjithçka që ShBA-ja ka bërë për lirinë dhe shtetndërtimin e Republikës së Kosovës. Veseli e ka falënderuar Albrightin që në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës ka ardhur në Prishtinë për të festuar bashkë me qytetarët lirinë e Kosovës. Me këtë rast mikja e Kosovës, Madeleine Albright, ka thënë se po ndihet si në shtëpinë e vet. "Faleminderit shumë për pritjen, zotëri kryetar! Unë po ndihem sikur në shtëpinë time", ka thënë Albright.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim ish-sekretaren amerikane të

sekretares Madeleine Albright. "Përmes këtij veprimi të Postës së Kosovës dëshirojmë ta ruajmë respektin për zonjën e madhe Albright", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ndërsa ish-sekretarja Madeleine Albright ka falënderuar kryeministrin Haradinaj dhe popullin e Kosovës, duke thënë se Kosovës i duhen liria, paqja dhe demokracia dhe se vlerëson progresin që është arritur në Kosovë gjatë këtyre njëzet vjetëve. Ajo është shprehur e vendosur që të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e zhvillimit dhe afirmimit edhe në të ardhmen.

Drejtuesit e institucioneve të shtetit të Kosovës kanë pritur në takime të ndara edhe ish-komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjeneralin Wesley Clark. Fillimisht ai është takuar me presidentin Hashim Thaçi nga i cili është nderuar me "Urdhrin e Lirisë".

Thaçi ka vlerësuar se Clarki është gjenerali i luftës më të suksesshme ajrore në shekullin 20. "Ish-komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, gjeneralin Wesley Clark, e dekorova me 'Urdhrin e Lirisë' për kontributin e madh që ka dhënë për lirinë tonë. Wesley Clark është gjenerali i luftës më të suksesshme ajrore në shekullin 20, me 78 ditë bombardime ndaj caqeve ushtarake dhe policore serbe", ka deklaruar Thaçi.

Ish-gjenerali i NATO-s, Wesley Clark, ka thënë se është përvojë e jashtëzakonshme për të kthimi në Kosovë për ta parë demokracinë, presidentin, Kuvendin, udhëheqjen dhe ekonominë e Kosovës krahasuar me kohën e tragjedisë 20 vjet më



këmbëngulësinë e saj bashkoi dhe mobilizoi krejt botën për ta ndaluar spastrimin etnik në Kosovë. Në 20-vjetorin e lirisë sonë, sekretaren Albright e dekorova me 'Urdhrin e Lirisë'. Ajo përjetësisht do të mbetet heroína jonë", ka deklaruar Thaçi.

Kurse ish-sekretarja Albright ka thënë se ShBA-ja ka bërë gjënë e duhur për Kosovën dy dekada më parë. "Jam krenare për gjithçka që keni bërë ju dhe ne për t'i arritur këto gjëra. Nuk do t'i harroj kurrë vitet e luftës, njerëz që brohorisnin 'Faleminderit USA!' Mendoj që ShBA-ja ka bërë gjënë e duhur. Jam e nderuar që jem këtu me ju. Kosova është vend i pavarur, prandaj meriton të njihet", ka thënë Albright.

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të mërkurën në një takim ish-

shtetit, Madeleine Albright. Kryeministri Haradinaj ka shprehur falënderimin e thellë ndaj zonjës Albright për angazhimin dhe kontributin e saj për lirinë dhe mbrojtjen e popullit të Kosovës në kohët më të vështira. "Ne kujtojmë me pietet dhe ndjenjë të respektit angazhimin tuaj gjatë luftës në Kosovë, për ndaljen e vrasjeve dhe të dëbimit të popullit tonë, si dhe për çlirimin e Kosovës nga forcat pushtuese serbe", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka thënë se Albright do të jetë përgjithmonë me zemrat e popullit të Kosovës. "Në familjet e shqiptarëve, në zemrat tona dhe në kujtesën historike të vendit, ju keni mbetur përgjithmonë", tha kryeministri Haradinaj.

Kryeministri Ramush Haradinaj në këtë rast i ka dorëzuar pullën postare të edituar nga Posta e Kosovës, me portretin e ish-

parë. Ai ka thënë se populli i Kosovës është duke ndihmuar vendin të ecë drejt Perëndimit. Në këtë kontekst, gjenerali Clark ka thënë se pret me padurim që Kosova të anëtarësohet në Bashkim Evropian (BE) dhe në NATO. "Pres me padurim kohën kur Kosova do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe NATO. Dua ta shoh këtë vend si

anëtar i NATO-s sepse NATO është për ata njerëz që besojnë në liri", ka thënë gjenerali Clark gjatë takimit me presidentin Hashim Thaçi.

Më pas ish-gjenerali i NATO-s, Wesley Clark, është pritur në takime të ndara edhe nga kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj.

Presidenti dekoron edhe ish-komandantin e KFOR-it, Xavier de Marnac

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar të mërkurën me Medaljen Presidenciale të Meritave edhe ish-komandantin e KFOR-it, Xavier de Marnac. Thaçi ka thënë se ish-koman-

danti i KFOR-it ka dhënë një kontribut të çmuar për forcimin e paqes dhe stabilitetit në vendin tonë. "Me Medaljen Presidenciale të Meritave e dekorova edhe ish-komandantin e

KFOR-it dhe më pas ish-shef i EULEX-it në Kosovë, Xavier de Marnac. Ai dha kontribut të çmuar për forcimin e paqes dhe stabilitetit në vendin tonë", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Republika e Kosovës ka shënuar 20-vjetorin e çlirimit

Kosova u është falënd

Ish-presidenti amerikan Bill Clinton dhe ish-sekretarja e shtetit Madeleine Albright janë pritur si heronj të mërkurën në Prishtinë. Në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, mijëra qytetarë kishin dalë për t'u shprehur mirënjohje dhe për t'i falënderuar zyrtarët e lartë amerikanë, të cilët para dy dekadave kishin vendosur për bombardimin e NATO-s mbi ish-Jugosllavinë. Clintoni dhe Albrighti janë shprehur krenarë që vendimi i tyre ka ndaluar spastrimin etnik të shqiptarëve nga forcat serbe. Me rastin e 20-vjetorit të çlirimit është bërë edhe zbulimi i bustit të ish-sekretares Albright

EPOKA E ENJTE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Për nder të 20-vjetorit të çlirimit, Prishtina ishte në festë të mërkurën. Mijëra qytetarë të Kosovës kishin dalë nëpër sheshet kryesore të Prishtinës për t'i përshëndetur dhe falënderuar ish-presidentin amerikan Bill Clinton, ish-sekretaren e shtetit Medelin Albright dhe gjeneralin amerikan Wesley Clark, të cilin ishin mysafirë specialë të këtij përvjetori.

Në shenjë falënderimi për NATO-n, e cila para 20 vjetëve ndali gjenocidin serbe në Kosovë, skena ku është zhvilluar ceremonia qendrore në Sheshin "Skënderbeu" ishte rregulluar në formën e logos së Aleancës Veriatlantike.

Ish-presidenti amerikan dhe ish-sekretarja e shtetit para dhjetëra figurave të rëndësishme vendore dhe ndërkombëtare dhe mijëra qytetarëve janë shprehur krenarë

mirënjohës që në udhëtimin tuaj të vështirë dhe të gjatë nuk ka pasur kthim të dhunës sistematike. Merita për këtë u shkon qytetarëve të Kosovës, të të gjitha etnive, të cilët kanë vendosur të jetojnë me shpresën e të ardhmes së duhur", ka thënë Clintoni.

Ai ka bërë me dije se veprimi i NATO-s për ta bombarduar ish-Jugosllavinë është përkrahur nga të gjithë anëtarët e Aleancës. "NATO-ja funksionon më së miri në botë. Gjenerali Clark ishte komandant, por ishin 19 shtete demokratike që e përkrahën atë veprim, i cili shpresoj që mos të përsëritet. ShBA-ja ka qenë pranë jush që 20 vjet, pavarësisht se çfarë partie politike ka qenë në Shtëpinë e Bardhë", ka thënë Clintoni, duke qenë falënderues edhe për pasardhësin e tij në Shtëpinë e Bardhë, George W. Bush, që njohu shtetin e Kosovës. Edhe ish-sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, e ka mbrojtur vendimin për intervenimin e NATO-s. Në ceremoninë

shtëpitë e tyre dhe ishin vendosur në Maqedoni. "Në ditët që pasuan të fushatës sonë kam vizituar një kamp me refugjatë të Kosovës në Maqedoni dhe më kujtohet kur po ecja nëpër tokën me pluhur, me 20 mijë të dëbuar, të rinj dhe të vjetër dhe një djalosh po mbante një pankartë: 'E dua Amerikën' dhe, në fund thoshte, se dëshiroj të kthehem në Kosovë. Unë ndalova dhe fola me nënën e tij e cila më tha që gjyshi i atij djaloshi kishte vdekur derisa po ikte nga Kosova dhe se ishte gjyshja e tij që po qëndronte ende në Prishtinë. Unë u ftova në një tendë ku një grup i grave folën për interesin e tyre për t'u kthyer dhe u thashë keni durim. Gjithashtu, u thashë se kur të ktheheni atje do të jenë ushtarët e NATO-s për t'ju ndihmuar që ta zhvillonin një jetë normale", ka thënë Albright.

Ndërsa presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka uruar të gjithë qytetarët për 12 qershorin, ditëlindjen e lirisë së Kosovës.

Është koha më e përshatshme për marrëveshje me Serbinë

Në ceremoninë qendrore të shënimit të 20-vjetorit të çlirimit ka folur edhe zëvendësdihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, Mathew Palmer, i cili ka thënë se ShBA-ja do të vazhdojë të jetë partnere mbështetëse e Kosovës. Ai i ka porositur institucionet e Kosovës që të angazhohen për fuqizimin e rendit dhe të ligjit.



Përurohet busti i Madeleine Albrightit

Nën ovacione të mijëra qytetarëve, ish-presidenti Bill Clinton, presidenti Hashim Thaçi dhe ish-sekretarja Madeleine Albright kanë përuruar bustin e kësaj të fundit. Ajo është shprehur shumë e lumtur me këtë nder që i është bërë. "Jam shumë e nderuar që të kem një bust në Prishtinë. Faleminderit shumë për këtë nder kaq të madh! Ky vend do të thotë shumë për mua", ka thënë Albright. Paska me humor ajo e ka falënderuar krijuesin e kësaj veprë: "Faleminderit që më keni bërë kaq të gjatë!" Tani sheshi ku është vendosur busti do ta mbajë emrin "Madeleine Albright".

"Një e ardhme e ndritur varet nga rendi dhe ligji, demokracia e fortë dhe llogaridhënia si dhe refuzimi i pandëshkueshmërisë", ka

deklaruar Palmer.

Ndër të tjera, ai ka folur edhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës



për vendimet e tyre të cilat ndalën spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës.

Presidenti i 42-të i ShBA-së, Bill Clinton, ka thënë se gjithmonë për të do të jetë një nder i madh që të qëndrojë në Kosovë. Ai ka deklaruar se ndihet krenar edhe për faktin se ishte në krye të politikës botërore që ndali gjenocidin dhe vrasjet në Kosovë, duke theksuar se ShBA-ja e ka mbështetur Kosovën në çdo fazë të zhvillimit të saj. "Para se të mendoni për të gjitha gjërat që duhet t'i bëni, jeni

qendrore për shënimin e 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, ajo ka thënë se vendimi për të ndërhyrë në Kosovë ishte i drejtë. "Aleanca jonë ishte e bashkuar dhe e fortë dhe më e rëndësishmja është se ia dolëm për arsye se kauza jonë ishte e drejtë dhe për arsye të qytetarëve të Kosovës përtej të gjitha pyetjeve, praktikave dhe politikave", ka thënë Albright.

Në adresimin e saj, ajo ka treguar për një premtim që ua kishte bërë para 20 vjetësh refugjatëve nga Kosova të cilët ishin larguar nga



eruese miqve të lirisë



Zbulohet pllaka për ish-presidentin Clinton

Në orët e pasdites në Bulevardin "Bill Clinton" është zbuluar pllaka e ish-presidentit të ShBA-ve, Bill Clinton. Me këtë rast, Clintoni ka thënë se pllaka është dhuratë shumë e çmuar për të. "Kjo është dhuratë shumë e çmuar për mua. Faleminderit për këtë pllakë që e keni vendosur këtu, sepse dëshiroj që çdo qytetar i Kosovës ta dijë se kjo do të thotë shumë për mua. Jo vetëm për atë që kam bërë për fëmijët e tyre, për veten, por për atë që kam bërë për tërë Evropën", ka thënë ai. Clintoni me këtë rast ka pasur edhe një porosi për Kosovën.

"Mund ta shfrytëzosh këtë rast të them që, nëse njerëzit janë të lirë gjithandej, t'i ndërtojnë jetët e tyre në mënyrën më të mirë që mundën. Jo të brengosen se ku kanë lindur, se çfarë përkatësie etnike kanë, nëse janë gra ose burra - çfarëdo ndasie mes qenieve njerëzore do të injorohet përderisa jeni njerëz të mirë. Nëse i bindeni ligjit, nëse punoni shumë, urrejtja do të mundet përmes dashurisë. Kjo është porosia për Kosovën", ka thënë Clinton. Në pllakë është gdhendur një nga deklaratat e ish-presidentit Clinton pasi u dha urdhri që for-

cat e NATO-s ta bombardojnë Serbinë për ta çliruar Kosovën. Përveç ish-presidentit amerikan, ish-sekretares së shtetit dhe generalit Clark, në ceremoni kanë marrë pjesë shumë personalitete të tjera që ndihmuan në çlirimin e Kosovës, si dhe zyrtarë të lartë të vendeve fqinjë. Ish-presidenti amerikan, Bill Clinton, ka përmbyllur të mërkurën vizitën e tij në Kosovë. Para largimit, ai është përcjellë për në Aeroportin e Prishtinës nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, me të cilin ka zhvilluar edhe një takim.

"Ecja e Lirisë", Clintoni dhe Albrighti dorë për dorë

Disa orë pas përfundimit të ceremonisë qendrore, ka nisur manifestimi "Ecja e Lirisë" nëpër sheshet qendrore të Prishtinës. Në ballë të kësaj ecje ishin ish-presidenti i ShBA-së, Bill Clinton, dhe ish-sekretarja amerikane, Madeleine Albright. Gjatë kësaj ecje nuk ka munguar kujdesi i presidentit Clinton për ish-sekretaren. Ai vazhdimisht e ka mbajtur atë për dorë gjatë ecjes.

Qytetarë të shumtë kishin dalë në shesh për ta përshëndetur parakalimin e dy ish-zyrtarëve të lartë të ShBA-së derisa nuk janë ndalur thirrjet e tyre "USA", si dhe emrat e Clintonit dhe Albrightit. Gjatë ecjes, një i moshuar i ka dhuruar një plis ish-presidentit amerikan, të cilin Clintoni e ka pranuar me kënaqësi, teksa ka vazhduar ta mbajë në duar dhuratën e pranuar.

Bashkë me Clintonin dhe Albrightin "Ecjen e Lirisë" e kanë bërë edhe shumë personalitete të larta ndërkombëtare, që kishin marrë pjesë në ceremoninë qendrore dhe liderët shtetërorë të



Kosovës. Ecja ka vazhduar deri afër bustit të ish-obeliskut "New Born", ku është bërë zbulimi te busti i ish-sekretares Madeleine Albright.



dhe Serbisë, duke thënë se tani është koha ideale për t'u arritur marrëveshja përfundimtare në mes të të dyjave vendeve. "Nuk ka kohë më të mirë, më të përshtatshme se tani për ta bërë këtë. Greqia dhe Maqedonia (e Veriut) së fundmi e arritën pajtimin dhe ka qenë kjo e arritur nga liderë largpamës dhe natyrisht duke i harruar konfliktet e kaluara", ka deklaruar Palmeri.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, në këtë ceremoni ka folur për procesin e normalizimit të dy shteteve. Ai e ka ftuar presidentin Vuçiq që ta njohë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.

Ndërsa kryetari i Kuvendit, Kadri

Veseli, ka thënë se bota perëndimore në krye me ShBA-në para dy dekadash ka shpëtuar kombin shqiptar. "Ju, 20 vjet më parë, shpëtuat një komb të tërë. Shpëtuat fëmijët e pastrehë dhe të frikësuar. Prindërit e pashpresë dhe të tmerruar. Nënata, gratë, vajzat e pambrojtura. Një popull të tërë nga gjenocidi. Dhe, mbi të gjitha, u dhatë kuptim vlerave njerëzore, për të treguar se askush, asnjëherë, nuk do të shtypet, nëpërkëmbet dhe rrezikohet vetëm pse tjetri mund ta bëjë këtë dhe është më i fortë. Garant i këtij humanizmi qëndron gjithmonë vendi i lirisë dhe demokracisë në botë - Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Veseli.



Merren masa për shkelësit e rregullave gjatë mbajtjes së provimit të maturës shtetërore

Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka konstatuar se në përgjithësi testi ka shkuar mirë dhe nuk ka pasur parregullsi të mëdha që ndikojnë në proces. Gjatë mbajtjes së testit janë përjashtuar nga procesi 54 nxënës, të cilët do ta humbin këtë afat të testimit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Komisioni Shtetëror i Maturës (KShM) ka mbajtur të mërkurën takim, ku ka analizuar raportet e ardhura nga terreni pas përfundimit të ditës së parë të provimit të Maturës Shtetërore në regjionin e Prishtinës. Komisioni ka konstatuar se në përgjithësi testi ka shkuar mirë dhe nuk ka

pasur parregullsi të mëdha që ndikojnë në proces. Gjatë mbajtjes së testit janë përjashtuar nga procesi 54 nxënës, të cilët do ta humbin këtë afat të testimit.

Administrueset të cilat i kanë shkelur rregullat janë: Luljeta Gashi, Kimete Mejteni dhe Hazbije Zeqiri, të cilat kanë qenë të angazhuara në Podujevë. Edhe për dy administrues të tjerë janë duke u vërtetuar provat për shkelje

dhe gjatë ditës së nesërme, nëse vërtetohen shkeljet, do të publikohen emrat e tyre. Ndaj këtyre administruesve të lartcekur do të iniciohen masat sipas vendimeve në fuqi.

Me këtë rast, Komisioni Shtetëror i Maturës ka falënderuar drejtoritë komunale të arsimit të komunave përkatëse, për përgatitjet e duhura për këtë provim. Po ashtu, komisioni falënderon



edhe Policinë e Kosovës dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces dhe që e kanë kryer detyrën e tyre sipas rregullave të Provimit të Maturës Shtetërore.

Mbahet punëtorja për përmirësimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore për gra dhe fëmijë, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Fondin për Popullatë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA), që nga viti 2013 ka iniciuar procesin për auditin e vdekjeve maternale, bazuar në strategjinë globale të OBSH-së "Përtej numrave" (Beyond the numbers).

Në vazhdimësi të këtij procesi në Prishtinë është mbajtur punëtorja teknike me pjesëmarrje të konsulentëve ndërkombëtarë për auditin maternal - Sistemi i observimit dhe reagimit obstetrik (SORO). Duke përsëritur pjesëmarrësit në këtë punëtori, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, dr. Naim Bardiqi, ka thënë se punëtorja ka për qëllim zhvillimin e Sistemit të Observimit dhe Reagimit Obstetrik, (SORO) i cili pa dyshim është proces që do të ndikojë në përmirësimin e kujdesit maternal në Kosovë. "Shëndeti i nënës dhe fëmijës mbetet ndër prioritetet më të



rëndësishme të Ministrisë së Shëndetësisë për faktin se kjo është një fushë e rëndësishme për të ardhmen e shëndetshme të popullsisë së çdo vendi, sepse jemi të bindur që një shoqëri që ka nënat dhe fëmijët e shëndoshë e ka edhe të ardhmen e sigurt", është shprehur Bardiqi. Ai ka thënë se dëshmia më e mirë e përmirësimit të cilësisë së shërbimeve janë indikatorët e përmirësuar të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave apo trendi i ndryshimit pozitiv dhe të qëndrueshëm të tyre.

Ndërkohë dr. Zarife Miftari nga UNFPA-ja ka theksuar se kjo

organizatë do të vazhdojë të kontribuojë për ta përmirësuar shëndetin e nënës në Kosovë, duke ofruar mbështetjen e nevojshme për MSh-në në procesin e zhvillimit dhe zbatimin e SORO si dhe për zhvillimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike në këtë fushë.

Punëtorja është udhëhequr nga dr. Mihai Horga, këshilltar i lartë në Institutin e Evropës Juglindore për Shëndetin riprodhues. Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit dhe aktorët kryesorë në fushën e shëndetit riprodhues në Kosovë janë pajtuar për hapat konkretë për zbatimin e SORO në Kosovë.

Limaj takon disa të rinj që bartin emrat që simbolizojnë çlirimin e Kosovës

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të vendit tonë, ka pritur në takim disa djem dhe vajza të cilët janë të pagëzuar me emrin Çlirimtar dhe Çlirimtare. Limaj ka thënë se ka qenë emocion i veçantë që në shënim të 20-vjetorit të çlirimit t'i presë në takim të rinjtë të cilët bartin emra që simbolizojnë çlirimin e Kosovës. "Djem dhe vajza të pagëzuar me emrat Çlirim

dhe Çlirimtare, të cilët kanë lindur në vitet 1999-2000, në epokën e lirisë së Kosovës dhe të cilët me krenari mbajnë këta emra. Këta emra të veçantë tregojnë historinë e lavdishme të Kosovës dhe në mesin e vizitorëve pata fëmijë të bashkëluftëtarëve të cilët e mbajnë me plot kuptim këtë emër. Emrat tuaj dhe puna juaj në shërbim të vendit do të jenë motiv dhe pjesë e historive e rrëfimeve për lirinë e vendit e brezave që do të vijjnë", ka thënë Limaj.



Histeroskopi lehtëson trajtimin e pacienteve në Gjinekologji

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Mjekët në Gjinekologji po kryejnë më lehtë punën në ndërhyrjet e ndërlikuara kirurgjike pas ardhjes së pajisjeve të reja. Sipas një njoftimi të QKUK-së, në bazë të raportit të punës, në këtë klinikë

gjatë periudhës janar-maj janë kryer 26 operacione me histeroskop në mitër, duke mbuluar të gjitha rastet që kishin nevojë për një intervenim të tillë.

Histeroskopi është një aparat e mjekësore

gjinekologjike, ku me anë të kamerës vërehen të gjitha ndryshimet në qafën dhe kavitetin (hapësirën) e mitrës. Klinika e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është pajisur me këtë pajisje gjatë vitit të kaluar. Për ta

rritur cilësinë e shërbimeve, Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK, njëkohësisht, e kanë furnizuar këtë klinikë edhe me thikë ultrasonike, laparoskop, tavolina gjinekologjike-operative dhe llamba operative për të gjitha sallat.



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka mbajtur konferencë për medie me rastin e 14-vjetorit të themelimit të kësaj lëvizje

Kurti: Vetëvendosja është mundësi për qytetarët dhe garanci për shtetin

Lëvizja Vetëvendosje (LV) kurrë nuk ka pasur më shumë mbështetje dhe në zgjedhjet e ardhshme do të jetë qeverisja që siguron drejtësinë, paqen dhe dinjitetin. Kështu ka deklaruar lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në 14-vjetorin e themelimit të kësaj lëvizje. Në një konferencë me gazetarë ai ka thënë se Vetëvendosja sot është mundësi për qytetarët dhe garanci për shtetin e Kosovës. Sipas Kurtit, përgjatë këtij rrugëtimi Vetëvendosje, përveç kritikës, ka paraqitur përherë edhe alternativa

sonë. Para 14 vjetëve, në murin që ndante selinë e pushtetit të UNMIK-ut prej neve që asokohe konsideroheshim banorë të Kosovës dhe jo qytetarë, shkruam parullën 'jo negociata, Vetëvendosje!', ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se nga ajo kohë, përveç kritikës, Lëvizja ka paraqitur përherë edhe alternativa. Në këtë kuadër ai ka përmendur fushatën për bojkotimin e produkteve të Serbisë në Kosovë që filloi në maj të vitit 2006, fushatën 'Blej shqip' në shtator të vitit 2009 dhe fushatën 'Duaje tënden' për rritjen e konsumit të prodhimeve vendore në vitin 2011. "Kemi kundërshtuar planet dhe ndërhyrjet e Serbisë në Kosovë dhe kemi argumentuar e kemi angazhuar për afrimin e bashkimit me Shqipërinë. Mirëpo, ne nuk e shohim bashkimin e këtyre vendeve tona përmes dobësimit apo dështimit të shteteve tona, por nëpërmjet

forcimit të tyre", është shprehur Kurti, duke shtuar se 'PANhajnja' e zullumit në politikë dhe e tajkunëve në ekonomi duhet të marrë fund e do të marrë fund. Kurti ka rikujtuar se gjatë aktivitetit të Lëvizjes Vetëvendosje janë vrarë aktivistët Mon Balaj dhe Arben Xheladini, kurse në burg është mbytur aktivisti Astrit Dehari. "Në rrugëtimin tonë nuk jemi sprapsur e as nuk jemi ndalur, nuk kemi devijuar dhe as s'jemi lodhur, edhe kemi bashkëpunuar me të tjerë edhe dyert i kemi pasur të hapura për të tjerët, për të mirën e vendit dhe interesin e përgjithshëm kemi ecur drejt e qartë, fortë e fuqishëm", ka thënë ai.

Kurti ka theksuar se Lëvizja Vetëvendosje kurrë nuk ka pasur më shumë mbështetje dhe se në zgjedhjet e ardhshme PAN-i do të mundet, e Kosova do të shpëtojë e do të përparojë. "Ndryshimi demokratik e përparimtar do të

jetë ai në të cilin opozita e vërtetë dhe e drejtë bëhet qeverisje e ardhshme e mirë. Vetëvendosje sot është mundësia për qytetarët e Kosovës dhe garancia për Republikën e Kosovës. Nesër ajo do të jetë qeverisja që shërben e mbron, që rrit produktin, buxhetin dhe punësimin, që siguron drejtësinë, paqen dhe dinjitetin", ka thënë Kurti.

Ndërsa deputeti Liburn Aliu ka përmendur shkrimin e parullës 'Jo negociata, Vetëvendosje!' në murin e UNMIK-ut si aksionin e parë që hapi një valë të re të aktiviteteve të shumta politike në funksion të pengimit të proceseve të dëmshme që po i gatuheshin Kosovës asokohe. "Ne donim që liria e Kosovës të ndërtohej mbi vullnetin e qytetarëve të saj dhe jo përmes negociatave me pushtuesin. Ishim të bindur se liria dhe zhvillimi i vendit do të jenë të qëndrueshme vetëm duke u bazuar në këtë vullnet", ka thënë ai, duke theksuar bindjen se negociata do ta kishte për bazë vetëm stabilitetin e përkohshëm dhe jo lirinë, barazinë dhe të drejtat që ne si popull po i kërkonim. "Tubime, aksione, deklarime dhe punë e shumë vullnetare dhe e përditshme në çdo qendër të Kosovës u zhvilluan nga vera e vitit 2005. Këto u shoqëruan me arrestime dhe dhunë të përditshme, por ne nuk u zbrapsëm ngaqë ishim në rrugën e drejtë të kundërshtimit të planit të negociatave me Serbinë", ka deklaruar Aliu.

Ai ka kujtuar se Lëvizja nga takimet e vogla kaloi në tubimet e mëdha, ndërkohë që pushteti vetëm sa shtonte radhët e policëve. "Në çdo përvjetor, në ligjërimin tonë mbeti përherë e njëjtë një fjali, jemi më të fortë se vitin që shkoi. Edhe sot ne jemi më të fortë se kurdoherë deri më tani dhe të tjerët janë më të dobët se kurdoherë deri më tani", ka theksuar Aliu, duke shtuar se lëvizje të tilla ka pasur çdoherë përgjatë dekadave të shkuara dhe se Lëvizja është vetëm një vazhdimësi e përpjekjes së një kombi të vogël drejt forcimit të vet.

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se 12 qershori është dita e çlirimit të Kosovës dhe ditëlindja e Lëvizjes Vetëvendosje. Në një konferencë për medie ai ka treguar se gjatë këtyre 14 vjetëve Vetëvendosja ka

kundërshtuar planet dhe ndërhyrjet e Serbisë në Kosovë si dhe është angazhuar për afrimin dhe bashkimin me Shqipërinë përmes forcimit të dy shteteve. "Kur çlirimi kishte mbushur gjashtë vjet dhe pavarësia po shtyhej prej vitit në vit, lindi Lëvizja Vetëvendosje. 12 qershori është dita e çlirimit të Kosovës, por edhe ditëlindja e Lëvizjes



Bytyqi: Përgatitjet janë bërë që testi i maturës të dalë me rezultate reale

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka vizituar maturantët gjatë mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore në Shkollën e Mesme "Dr. Ali Sokoli" në Prishtinë, për ta parë nga afër mbarëvajtjen e këtij procesi. Ministri Bytyqi ka uruar matu-

rantët për suksese në këtë test, ndërsa ka thënë se shpreson se çdo gjë do të shkojë mirë kudo në shkollat tona, ashtu siç është planifikuar dhe janë bërë përgatitjet që ky test të dalë me rezultate sa më reale. "Gjatë vizitës që u bëmë maturantëve, pamë se çdo gjë ka filluar mbarë dhe me kohë. Nuk është

vërejtur ndonjë parregullsi dhe shpresoj se gjatë tërë ditës, deri në mbyllje të testit, gjithçka do të shkojë mbarë. Çdo parregullsi eventuale që mund të ndodhë, qoftë nga nxënësit, vëzhguesit apo kushdo qoftë tjetër, do të veprohet sipas akteve ligjore në fuqi", ka thënë ministri Bytyqi.



Diskutohen specifikat e projektligjit për partneritete publiko-privat



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Gjatë tryezës së organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë rreth funksionimit të partneriteteve publiko-privat, bizneset nga sektori privat diskutuan rreth kushteve, parimeve dhe dispozitave që dalin nga ky projektligj për rregullimin e partneriteteve publiko-privat (PPP) me ndikim në sektorin privat.

Ramis Ahmetaj, konsulent biznesi, ka thënë se ky projektligj synon të adresojë çështje të cilat janë problematike në lidhje me partneritetet publiko-privat (PPP) si pronësia mbi projektin, teknologjia e transferueshme nga sektori publik në atë privat, si dhe kohëzgjatja e planifikimit të projektit, duke përfshirë këtu hapësirën fiskale.

Ahmetaj ka theksuar se përcaktimi i një vlere minimale të projekteve të cilat do të kualifikoheshin për PPP-në do të mirëpretej sepse projektet në vlera të ulëta monetare nuk paraqesin interes publik dhe paraqesin rreziqe të shumta.

Drejtori i Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat nga Ministria e Financave, Ilir Rama, ka thënë se projektligji për partneritete publiko-privat (PPP) parasheh kritere specifike të cilat do të ndikojnë në rritjen e fleksibilitetit në kontrata si dhe zgjidhjen e problemit rreth kohëzgjatjes së madhe të aprovimit të projekteve. Ai ka përmendur bashkëpunimin me sektorin privat si kyç për adresimin e çështjeve të rëndësishme për zbatim më të mirë të dispozitave të ndryshme, duke përmendur se ndihma e dhënë nga sektori privat përmes rekomandimeve gjithmonë është reflektuar në strukturim më të mirë të ligjeve nga ana e institucioneve relevante.

Rama ka shtuar se përmes këtij projektligji kanë propozuar rikthimin e ofertave të pakërkua si dhe adresimin e mungesës së kapaciteteve të menaxhimit të projekteve nga ana e institucioneve relevante.

Delegacioni i lartë i BQK-së, pjesëmarrës në konferencën e organizuar nga Banka Qendrore Evropiane

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Flamur Mrasori, i shoqëruar nga anëtarë të Bordit, Behxhet Brajshori, po marrin pjesë në konferencën e tetë të nivelit të lartë të organizuar nga Banka Qendrore Evropiane me temë "Përgjigja e vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore ndaj ndryshimeve në fushën tregtare dhe financiare". Fjalën mirëseardhëse për pjesëmarrësit e kësaj konference e ka mbajtur presidenti i

BQE-së, Mario Draghi, kurse folëse kryesore është drejtoresha menaxhuese e FMN-së, Christine Lagarde. Kjo konferencë vjetore është e nivelit të lartë, e cila kësaj radhe është organizuar në dy sesione kryesore me tema shumë të rëndësishme dhe me folës nga institucione të larta financiare botërore si FMN-ja, Banka Botërore, BERZh-i, përfaqësues të institucioneve të Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësues të bankave qendrore të vendeve të ndryshme evropiane.



Përdoruesit e telefonave iPhone po kanë vështirësi të lidhen me rrjetin 4G



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Pas implementimit të procesit më kompleks të kodit shtetëror të Kosovës, një numër i kufizuar i përdoruesve të telefonave iPhone po has në vështirësi të lidhen me rrjetin 4G. IPKO-ja ka njoftuar se është duke zhvilluar

komunikim në baza ditore me kompaninë Apple për sanimin e këtij telashi sa më shpejt që të jetë e mundur. "Inxhinierët e Apple po punojnë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, së bashku me ekipin tonë. Mungesa e rrjetit 4G në disa pajisje telefonike iPhone

ka të bëjë me reagimin e pajisjes drejt rrjetit të ri. Përdoruesit e telefonave iPhone, të cilët nuk janë të prekur nga këto vështirësi, tashmë veç janë të lidhur me rrjetin

4G. Ndërkohë, konsumatorët e afektuar mund të lundrojnë në rrjetin 3G, kudo që është i disponueshëm. IPKO falënderon të gjithë konsumatorët e saj për mirëkuptimin dhe durim gjatë këtij procesi të rëndësishëm", është thënë në njoftimin e IPKO-s.

Institucionet publiko-private kanë nevojë për shërbimet e konsulencës

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Në Prishtinë është shënuar të mërkurën Dita Globale e Konsulencës e cila shënohet në 60 shtete të ndryshme të botës. Me këtë rast, Business Consultants Council (BCC) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) kanë organizuar një eveniment në nivel të institucioneve publike dhe private për rëndësinë e profesionit të konsulencës, akreditimit të saj dhe vlerën e operimit të saj në institucione. Po ashtu, si tërësi, është mbajtur mbledhja e përgjithshme e Kuvendit të Anëtarëve të BCC-së dhe një organizim i formatit B2C në mes të bizneseve SME dhe konsulentëve, në mënyrë që të rritet bashkëpunimi mes tyre. BCC-ja është shoqata e vetme në Kosovë, qëllimi i së cilës është promovimi dhe ruajtja e standardeve profesionale në sektorin e konsulencës, e njohur nga homologët e saj ndërkom-

bëtarë për profesionalizmin, etikën dhe standardet e përsosmërisë. BCC-ja është anëtare me të drejta të plota në rrjetin ndërkombëtar ICMCI që ngërthen 2 milionë konsulentë në mbarë botën.

Eventi ka pasur për qëllim diskutimin për perspektivën, rëndësinë dhe njohjen e konsulencës si profesion përmes bashkëpunimit në hapa konkretizues për këtë proces, ku në krahasim me vitin e kaluar i dhënë është një shtytje profesionale të konsulencës. Janë arritur dy marrëveshje bashkëpunimi me karakter lokal dhe rajonal mes BCC-së dhe dy institucioneve.

Bashkëpunimi i parë është zyrtarizuar me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit mes BCC-së dhe projektit ACCESS, me fokus kryesor në fondin e digjitalizimit që do t'i ndihmojë NVM-të në Kosovë, projekt i cili do ta fillojë implementimin në muajin korrik.

Bashkëpunimi i dytë është zyrtarizuar me nënshkrimin e

memorandumit të bashkëpunimit në mes të BCC-së dhe Albanian Consulting Network (ACN), e cila do të kontribuojnë në shkëmbimin e shërbimeve, bashkëpunimet e ndryshme dhe zhvillimin mes institucioneve nënshkruese.

Në pjesën e dytë të organizimit është mbajtur një panel i përbërë prej profesionistëve nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, BERZh-i, projektin Alled 2 dhe projektin ACCESS (të dy këto të fundit të financuara nga Agjencia Austriake për Zhvillim).

Ministri i Arsimit, Shyqyri Bytyqi, ka vlerësuar se të gjitha institucionet publiko-private kanë nevojë për shërbimet e konsulencës menaxheriale dhe ekspertët konsulentë si vlera të shtuara dhe që duhet të punohet për vetëdijesimin e bizneseve për përdorimin e këtyre shërbimeve. Ministri Bytyqi u zotua se do të japë kontribut bashkë me AKK-në lidhur me standardin e profesionit të konsulencës, në

përputhje me normat ndërkombëtare të konsulencës menaxheriale.

Lah Nitaj nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka shpjeguar kriteret për krijim të standardeve, duke theksuar që mund ta ndihmojë BCC-në në këtë aspekt, pas modifikimeve të fundit të bëra nga ana e shoqatës.

Anton Gojani nga projekti Alled 2 ka përshkruar procesin e krijimit të standardeve, duke u nisur nga individët që i hartojnë, pjesën e verifikimit, klasifikimit të profesioneve dhe parimeve për të qenë konsulent. Gojani ka theksuar se roli i shoqatës është që t'i shtyjë përpara proceset e akreditimit dhe validimit të profesionit të konsulencës.

Leonora Kusari nga BERZh-i ka konfirmuar që janë gjithmonë të gatshëm ta përkrahin shoqatën BCC në rrugëtimin për kualifikimin dhe certifikimin e konsulentëve dhe validimin e profesionit të konsulencës.

Një nga sfidat që duhet të trajtohet është vetëdijesimi i

institucioneve publike për përdorimin e shërbimeve konsulente dhe njohjen e tyre, duke mos përdorur në të njëjtën kohë të drejtën për certifikim të konsulentëve.

Jehona Lluka, drejtoreshë ekzekutive e institutit BCC, ka prezantuar në Kuvendin e Përgjithshëm të Anëtarëve të gjitha të arriturat e shoqatës dhe planin strategjik për të ardhmen. Si konkluzione nga ky organizim, u vendos të ndërmerren hapa konkretë nga të gjitha institucionet përkatëse për finalizimin e procesit të standardit të konsulencës, bashkëpunimi i fondit e digjitalizimit që do t'i ndihmojë NVM-të në Kosovë, shkëmbimin e shërbimeve rajonale, themelimi i komitetit të etikës dhe profesionalizmit të BCC-së dhe krijimi i një raporti për numrin e konsulentëve në Kosovë dhe mundësinë e përfshirjes së tyre në BCC. Rekomandimet e tilla do të konkretizohen në iniciativa të ndërmarra nga BCC-ja bashkë me partnerët.



AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 47

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 47 përmes metodës së likuidimit shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje.

Për 119 asete sa ishin në shitje konkurruan 108 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 2 785 409 euro.

"Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkaq është bërë transmetimi i drejtpërdrejtë i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit", është thënë në njoftimin e AKP-së.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.



Në Prizren vazhdojnë rrënimet e ndërtesave me vlerë të trashëgimisë kulturore

PRIZREN, 12 QERSHOR (ER) - Qendra Historike e Prizrenit (QHP) ende është duke vuajtur nga rrënimet pa leje e të (pa)qëllimshme të ndërtesave me vlerë të trashëgimisë kulturore.

EC Ma Ndryshe përmes një njoftimi për media ka njoftuar se rasti i fundit është ndërtesa në rrugën "Berati", ku vërehet rrënimi i gati gjysmës së ndërtesës (rrënimet në enterier dhe muret e prapme të ndërtesës). "Ky rrënim bëhet më shqetësues për faktin se kjo

ndërtesë është pjesë përbërëse e projektit 'Revitalizimi dhe integrimi socio-ekonomik i komunitetit lokal në rrugën Marin Barleti' në Qendrën Historike të Prizrenit i hartuar nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Prizren dhe EC Ma Ndryshe, përderisa është financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasada Britanike në Prishtinë dhe është mbështetur nga Komuna e Prizrenit", është thënë në njoftimin e EC Ma Ndryshe.

Javë më parë ministri i Kulturës, Kujtim Gashi, ka theksuar se rruga "Marin Barleti" në Prizren do të revitalizohet dhe do të investohen mbi 2 milionë euro. "Projekti 'Revitalizimi dhe integrimi socio-ekonomik i komunitetit lokal në rrugën Marin Barleti në Prizren' është një projekt ambicioz dhe tepër i rëndësishëm për qytetin e Prizrenit, pasi ngërthen në vete trajtimin e 14 ndërtesave të banimit të cilat, fatkeqësisht, nuk janë në gjendjen e



dëshirueshme. Edhe përkundër faktit që zbatimi i këtij projekti paraqet një ngarkesë buxhetore për MKRS-në, ai do të zbatohet në përpikëri, në respektim të standardeve të larta profesionale dhe në zbatim të legjislacionit

në fuqi", kishte deklaruar Gashi.

EC Ma Ndryshe ka bërë apel te MKRS-ja dhe Komuna e Prizrenit, gjegjësisht inspektoratet përgjegjëse të këtyre dy institucioneve, të dalin në terren dhe të evidentojnë këto rrënimet dhe të marrin masa adekuat konform ligjeve në fuqi rreth këtij fenomeni të shkatërrimit të ngadalshëm e të (pa)qëllimshëm të ndërtesave pasi humbja e vlerave të trashëgimisë kulturore është proces i pakthyeshëm.



Pesë persona në Pejë akuzohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe mashtrim

PEJË, 12 QERSHOR (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve D. Sh., G. L., R. Zh. dhe G. Sh., për veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" dhe kundër të pandehurit I. K. për veprën penale "Mashtrim". I pandehuri D. Sh. akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar në Komunë të Pejës me dashje ka tejkalar kompetencat e veta, pa qenë i autorizuar, duke nënshkruar raportin mbi pranimin e

mallit, me çka i ka shkaktuar dëm buxhetit komunal të Pejës në vlerë prej 9 929 eurosh. Të pandehurit G. L., R. Zh. dhe G. Sh., si persona zyrtarë në Komunë të Pejës, përkatesisht anëtarë të komisionit për pranimin e mallit, me dashje nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, duke i shkaktuar dëm buxhetit komunal në vlerën e shumë së lartcekur. Kurse i pandehuri I. K., në cilësinë e pronarit të operatorit ekonomik, si fitues i tenderit për "Blerjen e makinës për mirëmbajtjen e barit artificial

për Qendrën Sportive në Brestovik të Pejës", me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, i ka shkaktuar dëm buxhetit komunal të Pejës në vlerë prej 9 929 eurosh. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit kanë përmbushur elementet e veprave penale të përshkruar si më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat iu vihen në barrë.

Ngrihet aktakuzë për vrasje në fshatin Studenqan të Suharekës

SUHAREKË, 12 QERSHOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit me inicialet B. G. për veprat penale "Vrasje e rëndë" nga neni 179, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, "Vrasje në tentativë", nga neni 178, lidhur me nenin 28 si dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 374, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, më 17.03.2019 në fshatin Studenqan, Komuna e Suharekës, i akuzuari, pas një mosmarrëveshjeje paraprake rreth çështjeve pronësore, me dashje privon nga jeta anëtarin e familjes, vëllanë I. G., në atë mënyrë që hyn tek dyert e oborrit të shtëpisë së K. G., me revole të markës HS - 9 e cal. 9x19 mm, shtënë një herë

në drejtim të I. G. Dhe, pas të shtënës, i ndjeri I. G., i plagosur futet brenda në shtëpi, ku i akuzuari fillon ta ndjekë nga pas. "Ndërkohë e dëmtuara N. G., pas dëgjimit të një zhurme, e hap derën e shtëpisë dhe e sheh B. G. të plagosur. I akuzuari vazhdon ndjekjen duke hyrë në dhomën ku ishte fshehur i ndjeri I. G. dhe shtënë në të katër herë në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar plagë nga arma e zjarrit, e që vjen deri te vdekja e të ndjerit I. G.", është thënë në njoftimin për media.

I akuzuari gjendet në paraburgim nga data 17.03.2019 dhe prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas Ligjit për veprat penale të cilat i vihen në barrë.



Komuna e Mitrovicës bën apel te qytetarët për kujdes në parandalimin e zjarreve

MITROVICË, 12 QERSHOR (ER) - Në ambientin e Komunës së Mitrovicës, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, ka mirëpritur në takim përfaqësues të policisë së Kosovës dhe përfaqësues nga njësia e zjarrfikësve. Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me organizimin e një fushate për vetëdijesimin e qytetarëve me qëllimin të parandalimit të zjarreve. Me këtë rast, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim,

Nehat Bahtiri, ka thënë se edhe në këtë vit është planifikuar të organizohen forma të ndryshme vetëdijesimi për qytetarët për mbrojtje nga zjarri.

Kështu Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë përgatitur disa fletushka të cilat do të shërbejnë për informimin e qytetarëve rreth rreziqeve të mundshme nga zjarri. Po ashtu, drejtori Bahtiri ka bërë apel te

qytetarët që të jenë të kujdesshëm dhe vigilentë për shmangien e të gjithë shkaktarëve të mundshëm të zjarrit, me qëllim të mbrojtjes së jetës së tyre, shtazëve, pasurisë si dhe mjedisit. Në fund përfaqësuesit e policisë dhe ata të zjarrfikësve u shprehën të gatshëm të ndihmojnë me të gjitha kapacitetet që kanë në dispozicion, për të reaguar me kohë kur paraqiten rastet më emergjente siç është problemi i zjarrit.



20-VJETORI I ÇLIRIMIT, POR DREJTËSIA E HESHTUR!



Salihe SALIHU,
PhD kandidat dhe
veprimtare

Njëzetë vjet më parë forca morale gjëmoi anakënd botës dhe shkundi çdo tendencë e çdo pengesë për të mos vonuar finalizimin e çlirimit të Kosovës, që ishte e vetmja rrugë, rrugë pa kthim mbrapa. Kështu që, fara e gëzimit dhe fara e optimizmit u mbollën në ditën kur u mposht robëria, u çrrënjës okupimi dhe erdhi dita e lirisë në trojet shqiptare të

Kosovës falë luftës së popullit tonë të udhëhequr nga UÇK-ja dhe ndihmës së Aleancës Veriatlantike.

Kjo ditë ishte ditë e madhësisë, për të cilën shumë breza u sakrifkuan, ishte ditë e plotësisë të amanetit të heronjve e dëshmorëve. Në këtë ditë dhembja nga plagët shekullore si dhe humbja e më të dashurve u arkivuan në arkivin e historisë tragjike të popullit shqiptar për t'i lëshuar rrugën gëzimit që kishte shpërthyer si një ciklon nga emocionet për këtë ditë të shenjtë për ditën e çlirimit Kosovës.

Para se të vinte te kjo ditë finale, 20 vjet më parë, e gjithë bota u përcaktua për ta mbështetur forcën e armatosur të Kosovës, UÇK-në, meqë bijtë e bijat e UÇK-së, përkundër mungesave të mëdha në arma-

time, ishin të vendosur dhe të pamposhtur që ta jepnin jetën vetëm për ta sjellë lirinë në këto troje.

Në këtë deçenie të dytë gjithandej kujtohet kjo ditë e kthesës së historisë së popullit tonë, kjo ditë që solli paqen pas nënshkrimit të Marrëveshjes në Kumanovë. Këtij përvjetori madhështinë e ceremonisë festive e shton edhe arritja e figurave eminente si Bill Clintoni e Madelene Albright.

Janë këta dy politikanë të përmasave botërore si dhe Tony Blair e disa të tjerë që ishin të kyçur në kauzën e popullit të Kosovës. Këta politikanë me vendosmëri u rreshtuan në mbrojtje të vlerave morale që i dhanë legjitimitet ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë për t'i dhënë fund gjenocidit serb kundër shqiptarëve.

Legjitimiteti moral për ta

mbrojtur popullin e Kosovës kishte mposhtur qëndrimin e disa anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të cilët edhe sot e kësaj dite po lejojnë të përdoren kërcënime kundër fitores së popullit të Kosovës.

Është për t'u habitur fakti se si ky organ, me prestigj botëror, siç është Këshilli i Sigurimit të OKB-së, po lejon të shfaqen skena të këtylla të cilat po e dëmtojnë jashtëzakonisht imazhin e këtij organi si dhe seriozitetin e takimeve në këtë organ. Është non sens të vazhdohen takime të këtylla në këtë organ sepse po lë përshtypjen se ky organ më shumë i ngjason një organi të ndonjë distrikti në Komunën e Malmos se sa të ndonjë organi komunal apo regjional dhe ka humb peshën e vet si ndonjë organi me përmasa botërore.

Pavarësisht prej këtyre përplas-

jeve, është e qartë për Kosovën që si shtet i ri ende nuk ka siguruar ulësen në OKB, por rezultatet pas njëzetë vjetëve flasin qartazi se ne do të hymë edhe në ombrellën e këtij organi të OKB-së, por me shpresë që ky organ të reformohet dhe aty të mbretërojë e vërteta, drejtësia, paqja dhe siguria.

Tani, në shënim të njëzetvjetorit, fara e gëzimit dhe kultivimi i optimizmit për Republikën e Kosovës është që të bëhet partnere me të drejta dhe obligime të njëjta në botën perëndimore. Kosova si shtet i ri është i gatshëm të trokasë në këtë portë për të dëshmuar të vërtetat e ndodhura mbi popullin shqiptar në këto troje para njëzetë vjetëve dhe të kërkojë drejtësi në përputhje me konventat ndërkombëtare, për të mos lënë që drejtësia të mbetet e heshtur përgjithmonë.

KRIMINELI E VIKTIMA NUK FUTEN NË NJË THES



**Shkruan: Jakup
KRASNIQI**

E dëgjoni të thuhet shpesh: "Pa zgjidhjen e mosmarrëveshjes as Kosova e as Serbia s'kanë vend në BE"! Në të parë kjo thënie të duket se është krejt normale, e saktë, me përmbajtjeje e drejtësi politike por, në fakt, po të analizohet drejt, duke pasur parasysh raportet e Serbisë me Kosovën, thënia nuk ka as përmbajtje logjike, për të tjerat as mos të

flasim. Ngado që ta marrësh këtë thënie është gabim dhe gabim shumë i madh dhe pa mundësi arsyetimi.

Pse?

Të gjithë e dimë se nëse ka ndonjë vend në Evropën Juglindore që nuk ka qenë i gatshëm për marrëveshje politike në asnjë rast të vetëm, ai shtet ka qenë dhe vazhdon të jetë Serbia si dje ashtu edhe sot! E më së paku ndonjë faj

mund t'i ngarkohet Kosovës e cila në çdo kohë ishte për marrëveshje, bile edhe për marrëveshje kompromisi. Këtë e ka dëshmuar shumë herë, aty ku edhe prania e BE-së ishte e madhe.

Kosovës mund t'i qitet ky kusht vetëm për shkak të dëgjueshmërisë së skajshme të drejtuesve të saj, por jo pse ka apo kanë ndonjë përgjegjësi për mosarritjen e marrëveshjes me Serbinë.

Mjeku nuk mund ta shërojë pacientin para se ta caktojë diagnozën saktësisht! As rasti në fjalë nuk ka zgjidhje me hamendësime, përgjegjësia duhet të adresohet saktë.

Për rastin që po flasim ka shumë pasaktësi pasi adresa e fajtorit është më shumë se e ditur. Krimineli dhe viktimja e tij kurrë nuk mund të hyjnë në një thes. Madje as në drejtësi.

Hoti takohet me të rinjtë që përfaqësojnë Luginën e Preshevës

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, ka takuar dy të rinj që përfaqësojnë Luginën e Preshevës. Almin Shaqiri, këshilltar në Kuvendin Komunal të Preshevës dhe Altin Borici, shef i zyrës për të rinj në Komunën e Preshevës, iu kanë adresuar Rexhep Hotit me disa kërkesa të cilat ky i fundit i konsideron shumë konkrete dhe legjitime. "Ndër kërkesat më urgjente që kanë të rinjtë nga Lugina janë: Rritja e

kuotave për pranim të studentëve në universitetet publike në Kosovë, pranimi i më shumë studentëve në konvikt si dhe për mbështetje më të madhe nga institucionet e Republikës së Kosovës për rininë. U premtova se do të angazhohem maksimalisht që t'i përmbush kërkesat e tyre dhe se nëpërmjet Programit Nacional për Rini do ta bëjmë Luginën e Preshevës një vend edhe më të dashur për të rinjtë", ka thënë Hoti pas takimit.



Macroni mbështet Merkelin për presidente të Komisionit Evropian

PARIS, 12 QERSHOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel e ka mohuar vazhdimisht synimin për të vazhduar të qëndrojë në politikë pas mbylljes së mandatit si shefe ekzekutive, por gjithmonë e më shumë po përmendet së fundmi mundësia që ajo ta marrë në dorë drejtimin e Komisionit Evropian!

Gjasat që ky post t'i kalojë kandidatit kryesor, gjermanit Manfred Weber, i cili është njëherazi kreu i bllokut më të madh në Parlamentin Evropian, PPE-së, ishin dhe ato që e vuri në kurs përplasjeje Merkelin me Emmanuel Macronin.

Presidenti francez këmbëngul në formatimin e procesit në një kohë kur, sipas proceduarve ekzistuese, kandidati kryesor i cili përfaqëson grupin politik fitimtar në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, bëhet automatikisht drejtues i Komisionit.

Por mbështetjen që i mohon Weberit, Macron thotë se do t'ia jepte me kënaqësi Merkelit vetë. Në një intervistë për radio televizionin e Zvicrës, RTS, shefi i Elizësë tha se nuk mund të flasë për kancelaren gjermane, megjithatë theksoi se do të mbështeste çdo përpjekje të saj për t'u bërë presidente e krahut

ekzekutiv të bllokut evropian!

Evropës i nevojiten figura të reja, por edhe fuqi, citohet të ketë thënë ai. Mandati i kryetarit aktual të KE-së, Jean Cluade Juncker, po i afrohet fundit dhe spekulimet se kush do të zërë vendin e tij, sa vijnë e shtohen. Macron ka dalë hapur kundër Weberit me argumentin se ai është i panjohur për votuesit nëpër Evropë, ndërsa insiston se kësaj të fundit i nevojiten personalitete të fuqishme, njerëz me besueshmëri personale dhe aftësi për t'i përmbushur siç duhet detyrat e pozicioneve që mbajnë.



Trumpi dhe Bideni shkëmbejnë sulme verbale


Trumpi dhe Bideni kanë shkëmbyer replika që nga koha kur ish-nënpresidenti amerikan njoftoi kandidaturën e tij për zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, kur Trumpi e portretizoi demokratën Biden si një njeri që i mungon energjia. Biden, nga ana e tij, kritikoi stilin agresiv të presidentit Trump

WASHINGTON, 12 QERSHOR - Presidenti Donald Trump dhe ish-nënpresidenti Joe Biden dhanë të martën mesazhin e tyre politik në shtetin e Ajovas, secili me synimin për t'i bindur votuesit e zgjedhjeve të vitit 2020, se ai është njeriu me vizionin dhe forcën për ta udhëhequr vendin. Trumpi dhe Bideni kanë shkëmbyer replika që nga koha kur ish-nënpresidenti amerikan njoftoi kandidaturën e tij për në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, kur Trumpi e portretizoi demokratën Biden si një njeri që i mungon energjia. Biden, nga ana e tij, kritikoi stilin agresiv të presidentit Trump. Por replikat e tyre u bënë edhe më të forta, kur të dy u shfaqën në të njëjtin shtet, Ajova. Gjatë aktivitetëve të tij të së martës në Ajova, Trumpi u pa qartë se kishte në mendje zgjedhjet presidenciale të vitit 2020. Presidenti republikan, i cili pritet të kandidojë për t'u rizgjedhur, shfrytëzoi çdo rast për ta minuar punën e administratës Obama

dhe për ta përbuzur ish-nënpresidentin Biden. "Amerika nuk duhet të jetë kurrë peng i furnizuesve të huaj me energji, sikurse ndodhi nën drejtimin Obama - Biden. Joe gjumashi!", tha ai.

Argumenti kryesor i Trumpit në favor të tij ka qenë rritja ekonomike në Shtetet e Bashkuara, por politikën e tij për tarifën kanë dëmtuar fermerët amerikanë dhe disa prodhues, duke shkaktuar shqetësim se ekonomia mund të shkojë drejt rënies. Presidenti Trump këmbënguli se nga tarifën përfitojnë fermerët amerikanë. "Ne jemi duke marrë miliarda nga ato miliarda dollarë që hyjnë në vendin tonë përmes tarifave - u dhamë fermerëve 16 miliardë dollarë, sepse kjo ishte shumica më e lartë që Kina kishte përdorur ndonjëherë për ta blerë produktin tuaj", tha Trumpi.

Të martën Trumpi shkroi një sërë "Tweetesh", ku shprehte besimin për t'u rizgjedhur, duke përfshirë



një vlerësim ndaj tij në kohët e fundit në anketa. Sipas Raportit Rasmusen, mbështetja për të është tani rreth 50 për qind. Megjithatë, një sondazh i Universitetit Quinpiac i botuar të martën, tregoi se Joseph Biden është 13 pikë para Trumpit në mbështetjen që ai ka në nivel kombëtar.

Biden e filloi vizitën e tij dyditore në Ajova më herët të martën, duke vënë në shënjestër stilin e udhëheqjes së Trumpit. "Unë mendoj se ai përbën me të vërtetë një kërcënim për vlerat tona kryesore. Ai është kërcënim për

imazhin tonë në botë. Gjatë ceremonive me rastin e përvjetorit të zbarimit të trupave aleate në Normandi më la pa mend fakti që ai i sulmoi me 'Tweete' të gjithë, nga kryebashkiaku i Londrës tek aktorja amerikane Bette Midler", tha Bideni.

Kandidati demokrat për president me më tepër mbështetje, kritikoi gjithashtu deklaratat e Trumpit mbi tarifën. "Fakti është se ai e tërhoqi kërcënimin për tarifën me Meksikën kohët e fundit, sepse e kuptoi se rrezikonte të humbiste Michiganin, Ohajon, Ajovën dhe papritur - siç themi ne

në Delauerin Jugor - atij i vinte një thirrje nga Zoti... Por, do të shikoni, nëse situata vështirësohet, ai do të fillojë përsëri të kërcënojë me tarifën. Sipas mendimit tim, për të punëtorët amerikanë janë veçse një peng i lojës së tij", tha ai.

Tani për tani Bideni dhe Trumpi janë në pararojë të garës së partive të tyre përkatëse për zgjedhjet e ardhshme presidenciale, por nëntori i vitit 2020 është ende larg dhe zgjedhjet e 2016-s treguan se surprizat e minutës së fundit nuk mund të përjashtohen.

Kryeministri japonez synon përmirësimin e marrëdhënieve ShBA - Iran

TEHERAN, 12 QERSHOR - Kryeministri japonez, Shinzo Abe, ka arritur në Teheran në një vizitë që ai shpreson se do të ndihmojë në uljen e tensioneve në mes të Iranit dhe Shteteve të Bashkuara. Abe pritet të takohet me presidentin iranian Hasan Rohani dhe liderin suprem Ayatollah Ali Khamenei gjatë një vizite në Iran, njëherësh e para e një kryeministri japonez në detyrë, në më shumë se katër dekada. Teherani ke tensionuar marrëdhëniet me Uashingtonin, prej kur

Shtetet e Bashkuara janë tërhequr një vit më parë nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 në mes të Iranit dhe fuqive botërore. Prej asaj kohe, Uashingtoni ka rivendosur sanksione ndaj Iranit, ka ashpërsuar retorikën dhe ka rritur pranimin në Lindje të Mesme, duke rritur shqetësimin për ndonjë konflikt të armatosur.

Para se të nisej nga Tokio, Abe ka cituar "shqetësimin për rritjen e tensioneve në rajonin e Lindjes së Mesme". "Japonia dëshiron të bëjë

sa më shumë që është e mundur për të arritur paqe dhe stabilitet në rajon", ka thënë ai.

Tokio është një nga aleatët më të ngushtë të ShBA-së në Azi, si dhe ka marrëdhënie të mira me Teheranin. Mirëpo, vëzhguesit kanë shprehur shqetësim rreth rezultatit që mund të arrijë Abe, duke thënë se vizita e tij vetëm mund t'ia rrisë imazhin kryeministrit japonez pak para mbajtjes së zgjedhjeve në Kuvendin e Japonisë.





ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Zbulohet koka 40 000-vjeçare e një ujku

Një kokë ujku 40 000-vjeçare e prerë, e ruajtur me leshin dhe dhëmbët, është zbuluar në Siberinë lindore. Vendësit gjetën kokën e ujkut në brigjet e lumit Tirkhtyakh në Yakutia. Më pas e dërguan në Departamentin e Studimeve të Vaksinimit në Akademinë e Shkencave të Republikës së Sahas. "Kjo është hera e parë që gjendet koka e një ujkut të lashtë, që daton 40



000 vjet më parë, një ujk i rritur", ka thënë drejtori i departamentit, Albert Protopopov.

BARSOLETA E DITËS



Dy refugjatë po bisedonin në një pijetore në Angli. Njëri i thotë tjetrit që po i pinte gotat e birrës njëren pas tjetrës.
- A e di ti se nga alkooli vdesin çdo vit 10 000 anglezë?
- Unë jam shqiptar, zotëri.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min



Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton

FOTO E DITES



Një fëmijë i ikur nga lufta shihet në një kamp të improvizuar në rrethin e Abs, në provincën veriore të Jemenit. /AFP/

Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min



Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo

Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min




Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger

E rrallë

19 mijë dollarë për një tufë flokësh të Beethovenit

Shtëpia e ankandit "Sotheby" planifikon ta shesë një tufë flokësh të Ludwig van Beethoven, të cilin vetë kompozitori gjerman i preu dhe ia dha një miku pianist në vitin 1826. Flokët priten të shkojnë në ankand për 19 mijë dollarë. Por, drejtori i librave dhe dorëshkrimeve në "Sotheby", Simon



Maguire, ka thënë se tufa e flokëve mund të shitet më shumë se 19 000 dollarë.



16.05.2019 "THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Shumë miqësi dhe energji pozitive rreth vetes sot. Jeni ju që tërhiqni në orbitën tuaj njerëz që kanë gjithmonë mjaft optimizëm brenda tyre.</p>	 <p>DEMI Sot ju entuziazmojnë ata persona që kanë një ideal për të ndjekur dhe një projekt ambicioz për të realizuar. Doni t'i keni pranë me çdo kusht.</p>	 <p>BINJAKËT Raporti në çift do të lëkundet sot nga disa dyshime. Nëse jeni ju ai që duhet të justifikoheni kundrejt partnerit, duhet t'i gjeni fjalët e duhura.</p>	 <p>GAFORRJA Sot po mundoheni t'i mbyllni të gjitha punët e ditës sa më shpejt. Ju pret një darkë romantike për të cilën duhet t'i bëni të gjitha përgatitjet e duhura.</p>	 <p>LUANI Dita paraqitet e rrëmujshme me mjaft situata delikate që do ta kërkojnë ndërhyrjen tuaj. Do t'i shikoni të gjitha mundësitë për të zgjidhur një çështje.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Nuk është se do të ketë ndonjë ulje ose ngritje e madhe dita e sotme. Rutina dhe gjendja juaj disi indiferente thjesht do të lënë gjithçka të kalojë.</p>
 <p>PESHORJA Një ditë interesante ku nuk keni nevojë të komunikoni fare me partnerin sepse merreni vesh në ajër të dy. Bashkëpunimi do të jetë i përkryer.</p>	 <p>AKREPI Nuk po arrini dot të finalizoni një projekt konkret që duhet ta kishit përfunduar tashmë. Nëse hasni pengesa kërkonin ndihmën e ekspertëve.</p>	 <p>SHIGJETARI Pasioni dhe entuziazmi janë një miks i lezetshëm sot që do t'ju bëjë të provoni përvoja shumë të veçanta.</p>	 <p>BRICJAPI Megjithëse impenjimet e ditës ju mbajnë larg njëri-tjetrit, nëse në familjen tuaj ka një problem të vogël, keni treguar që jeni të gjithë të bashkuar.</p>	 <p>UJORI Sot doni të mblidheni me miqtë, por në një vend të qetë larg zhurmave të qytetit. Mjaft ta ndani mendjen dhe do t'u bashkohen të gjithë.</p>	 <p>PESHQIT Nuk është një ditë nga ato me të mirat, por gjithsesi do të arrini t'i merrni ato gjëra që doni nga dita e sotme. Kapni çastet që ju interesojnë.</p>


Bradley Cooper në klube pas ndarjes nga Irina Shayk



Bradley Cooper është duke e shijuar jetën. Pas ndarjes nga Irina Shayk ai u pa duke frekuentuar një klub në Hollywood. Aktori 44-vjeçar i "Guardians of the Galaxy" u kap në disa fotografi me

shokët vetëm pesë ditë pasi u dha lajmi i ndarjes së tij nga Irina. Bradley, që është nominuar shtatë herë për Oscars, ishte duke shkuar në klubin e famshëm Sunset Tower në Los Angeles, raporton "TMZ".

Drake me orë 750 mijë dollarëshe



Reperi 32-vjeçar mori pjesë në ndeshjen e pestë të finales së NBA-së në Toronto, Kanada, të hënën. Drake ishte i ulur në pjesën e publikut, por me një orë 750 mijë dollarëshe në dorë. Për

këtë ndeshje, fituesi i Grammy veshi një bluzë të thjeshtë "Nike" dhe pantallona të zeza në të njëjtën markë, por ishte ora e tij shumë eksplicite dhe shumë e shtrenjtë që ra në sy.



Dua nervozohet me fansat

Dua Lipa ka reaguar pasi disa persona e kanë akuzuar për fotoshopim të fotografisë së saj që e ka postuar në rrjete sociale. Këngëtarja nga Prishtina para pak javësh e ka

festuar arritjen e 30 milionë ndjekësve në "Instagram" duke e postuar një fotografi të saj si fëmijë. Ndërkaq tani po iu përgjigjet fansave që mendojnë se ajo i ka zmadhuar buzët në atë fotografi.


LaBeouf feston ditëlindjen me nënën e vet



Shia LaBeouf po e feston ditëlindjen e 33-të me gruan numër një të jetës së tij, nënën. Aktori dhe mamaja e tij Shayna u fotografuan të kapur për duarsh teksa po e shijonin motin e

mirë rrugës për të darkuar në restorant. Gjatë fundjavës së kaluar, aktori është parë me rroba që ia shfaqnin tatuazhet e këmbës teksa kryente blerje në dyqan ushqimesh.

Jorgos Seferis, dashuria për Zhaklinën



Më 10 dhjetor 1963, Akademia Suedeze do t'i akordojë për herë të parë Jorgos Seferisit Çmimin Nobel për Letërsi. Ndër shkrimtarët kandidatë për Nobel ishin emra shumë të fortë si Pablo Neruda, Vladimir Nabokov, Charle de Gaule, Samuel Beckett etj. Por, mesa duket, Beckett, ashtu si rezultoi edhe nga praktikat e Akademisë Nobel, të cilat për pesëdhjetë vite mbahen të fshehta, cilësohej si "nihilist" dhe "trishtues", Neruda si "komunist", dhe Nabokov si "i pamoralshëm". Ndërsa vetë poeti grek konsiderohej si poeti ideal i klasicizmit, që përfaqëson Greqinë si modelin e qytetërimit evropian. Jorgos Seferis, poet, eseist, përkthyes dhe diplomat është përfaqësuesi i parë i Brezit të Viteve 1930, pionieri i modernizmit në letërsinë greke. Emri i tij i vërtetë ishte Jorgos Seferiadis, ka lindur në 29 shkurt 1900 në Izmir, Azi e Vogël dhe ka vdekur në 20 shtator 1971. Pas arsimimit të mesëm në Greqi, do të regjistrohet për të vazhduar studimet e larta në Universitetin e Sorbonës, ku u diplomua me titullin Doktor në 1924, duke plotësuar në këtë mënyrë edhe një ëndërr të hershme të të atit. Pikërisht, vitet e qëndrimit të tij në Paris do të jenë vendimtarë për formimin e fizionomisë së tij poetike, edhe pse që në moshën katërbëdhjetë vjeçare kishte nisur të shkruante poezitë e tij të para. Ishte koha kur lëvizja e modernizmit ishte në kulmin e

zhvillimit të saj në mbarë Europën. "Lexoja Homerin dhe të gjitha revistat inovative të kohës. Isha admirueshmërisht i përhumbur dhe ëndërrimtar", do të shkruajë më vonë vetë poeti për vitet e tij studentore. Pas kthimit të tij në Greqi, ai u emërua nëpunës në Ministrinë e Jashtme (1926), periudhë në të cilën ai pati edhe një tragjedi familjare, humbjen e nënës së tij. Për këtë fatkeqësi, ai do të shprehet, i zhytur në melankoli dhe vetmi "Kam nevojë të flas. Askënd nuk kam. Ndoshta, jam unë fajtor. Por, ç'po ndodh këtu brenda? Sot pasdreke, pata përshtypjen se mendimi im është i zbrazët dhe në vend të tij ndodheshin dy të huaj që bisedonin dhe vendosnin për fatin tim. E pamundur të shkruaj. Sa kthej fletën, kam ndryshuar, jam bërë tjetër njeri". Por megjithë këto mendime të errëta, këto vite do të jenë një pikënisje e karrierës së tij diplomatike, e cila kulmoi me emërimin e tij si ambasador në Britaninë e Madhe në 1957. Por, diplomacia nuk do të përbëjë interesin e vetëm të juristit të porsadiplomuar. Ai vetë e pranon se shumë shpejt do të orientohet gjithnjë e më shumë drejt letërsisë. "Kam një dëshirë të madhe të shkruaj në çdo moment; çdo gjë më sjell një frymëzim, një tragjedi për të shprehur. Fatkeqësisht, vetëm idetë e mia i hedh në letër dhe i vë të fletë në gjumin e tyre të përjetshëm. Sirtari im është katandisur varrezë. Çdo ditë

varros edhe disa trupëza foshnjash që kanë dhënë shpirt". Ai u shfaq në letrat greke në 1931 me përmbledhjen poetike "Kthesë", e cila që në çastin e parë të qarkullimit të saj, ngacmoi interesin e shoqërisë letrare të Athinës, duke provokuar reagime pozitive dhe negative njëkohësisht. Ishte një përmbledhje me trembëdhjetë poezi, – ndër të cilat edhe poezia e frymëzuar nga Zhaklina, pianistja franceze me të cilën u dashurua, "Fjala erotike". Ajo do të jetë edhe një nga femrat më të rëndësishme të jetës së tij, e cila do ta pushtojë poetin për më shumë se një dhjetëvjeçar dhe pjesa më e madhe e poezisë së tij erotike do t'i kushtohet asaj. "Janë disa ndjenja në jetë që nuk zbehen kurrë..." do të shprehet ai për Zhaklinën.

Vlen të përmendet fakti se ai ka qënë Konsull i Përgjithshëm edhe në Korçë gjatë viteve 1936-1938 dhe ndërtesa ku ai ka shërbyer njihet ende në ditët e sotme si "Ndërtesa Seferi". Gjatë qëndrimit të tij dyvjeçar në Korçë, ai do të mrekullohet nga qyteti nën dëborë dhe do të frymëzohet për të shkruar disa nga poezitë e tij më të bukura. Veçojmë një letër shumë domethënëse që Jorgos Seferis i dërgon nga Korça të dashurës së tij në Greqi, ku ndër të tjera shkruan: "Dimri në Korçë nuk do të na pengojë, verën e kemi përpara...". Më pas, duke hedhur vështrimin mbi ndërtesën që ka përpara

dhe rrugicën e shtëpisë së tij në Korçë, ai do të shkruajë: "Në strehët kërcënojnë stalagmitet e akullta. Puhiza rrëmben grimcat e dëborës dhe një vel i hollë rrotullohet, ndehet mbi portat e mbyllura, grisat sokakëve e derdhet në fund të rrugës, ku pëlhura nis të mbulojë pllajën e kodrës. Të gjitha faqet e çatave me vështrim nga veriu, nisin fjalat e bardha. Mori cipëzash enden e vrapojnë të veshin pamjen përballë. Vallëzimet mbi çati daravitën trishtimin, buruar nga malli për të dashurën..."

Stina e ftohtë e Korçës, shkretëtira e fushave në dhjetor, vajzat me pelice që iu pëlqente të imitonin gratë e Parisit, ashtu si Korça tundohej nga ëndrra për t'u quajtur Parisi i vogël. Të gjitha këto do të linin mbresa te poeti. Pa dyshim, Korça në formën e zemrës ku netëve kitarat përcillte poshtë ballkoneve të Korçës serenatat e bukura ku qyteti dremiste dhe zgjohej mbi supin e një mali dhe në zemër mbante kristale...

Ai do të mrekullohet gjithashtu edhe nga liqeni i Pogradecit, me të cilin bashkëidentifikohet edhe trishtimi i tij si poet. Në kujtimet e tij gjejmë të tjera përshkrime emocionuese: "E ndala shoferin në një majë. Para meje shtrihej një sipërfaqe plot me ujë. Përballë male shumë të lartë. Zbrita. I gjithë vendi ishte i mbuluar me dëborë. Vështrova, duke kërkuar në atë masë uji një barkë apo anije të vockël. Do të thosha se m'u duk si një det i

vdekur. Ishte liqeni i Ohrit... I bukur me ujëra të kaltra... magjik..."

Ai do të vizitojë edhe qytetin historik të Krujës, për të cilin shkruan: "Pardje vajta ekskursion deri në Krujë, që është në një shpat mali mbi Tiranë, një fole shqiponjash. Fshat i bukur dhe piktoresk, atdheu i Gjergj Kastriot Skënderbeut, kushdo e kupton këtu për mrekulli se si copëtonte mijëra armiq, duke zbritur nga malet".

Në gjuhën shqipe, poeti i madh grek është përkthyer pas viteve 1990 dhe më konkretisht, për lexuesin shqiptar ai prezantohet me dy vepra të përkthyer: Poezi, përkthyer nga Perikli Jorgoni, Shtëpia Botuese "Albin", Tiranë 1996, dhe Legjendë, përkthyer nga Niko Kacalidha, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë 2010, pa harruar të përmendim edhe poezi të përkthyer e të botuara në revista të ndryshme letrare, së bashku me shkrime të ndryshme mbi krijimtarinë e tij letrare.

Viti 2018 është shpallur "Viti Seferis" në Greqi dhe në këtë kuadër në mbarë Greqinë dhe jashtë saj janë organizuar aktivitete të ndryshme letrare dhe shkencore në përkujtim të veprës së tij madhështore. Në Shqipëri, është menduar organizimi i një takimi letraroshkencor në mars të 2019, nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Dega Greqisht në bashkëpunim me ente të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Pesë ide për të rinovuar ballkonin pa shpenzuar shumë

T'i japësh një pamje të re hapësirës së hapur të shtëpisë tuaj me një buxhet të reduktuar në minimum është e mundur: ja se si! Më në fund ka ardhur stina e bukur e verës dhe dëshira për të qenë jashtë është jashtëzakonisht e madhe.

Nëse kemi një ballkon apo një tarracë të vogël ky është sezoni ideal për ta shijuar plotësisht atë dhe, edhe nëse dimensionet

janë të vogla, ka zgjidhje që mund t'i japin jetë kësaj hapësire dhe pa shpenzuar shumë: le t'i zbulojmë së bashku. Duket e lehtë për t'u thënë dhe shumë e vështirë për t'u bërë: tashmë sepse kur mendojmë për rinovimin e orendive shtëpiake, ideja e fillimit të shpenzimeve më shumë se sa duhet, fillon të na ngacmojë dhe na bën që të stepemi në ëndrrat

tona. Por të arredosh ballkonin me pak para, është e mundur, le të shohim se si.

Një dysheme druri: një mbulesë prej druri mund të krijojë një efekt shumë mikpritës dhe ju lejon të ecni zbatshëm edhe në tarracë. Sipërfaqja është minimale, duke qenë një hapësirë me përmasa të reduktuara, prandaj sipas ekspertëve të 'Habitissimo', një portal i

dedikuar botës së rinovimit në shtëpi, kostoja e parketeve në natyrë nuk do të jetë e lartë, por efekti me siguri do të jetë "i pashembullt".

Një kopsht urban: sa e lehtë është të japësh një ngjyrë të ngjyrosur në tarracë? Disa vazo me ngjyra të varura në mur janë të mjaftueshme për të krijuar një kopsht madhështor vertikal urban. Jo vetëm që dekorojnë

tarracën, por bimët aromatike do të jenë të përkryera edhe për përdorim në kuzhinë. Basil, nenexhik, rozmarinë, erëza të freskëta: këto janë vetëm disa nga shembujt e bimëve të përshatshme për këtë lloj kopshtit.

Një kopsht vertikal: në ballkone më të vogla është shumë e dobishme për të pajisur muret për të shfrytëzuar në maksimum hapësirën. Një mur vertikal lejon, për shembull, të varni objekte të dobishme, bimë dhe dekorime të tjera duke përdorur një hapësirë që përndryshe do të mbetet e papërdorur. Paleta të konvertuara prej druri: vazhdon tendenca për të ricikluar paletat prej druri. Në web ka shumë mësim të dobishme për të ndërtuar jo vetëm divanet në paleta, por edhe tavolina dhe mobilie të llojeve të ndryshme të përsosura për jashtë. Një mënyrë definitivisht ekologjike dhe ekonomike për të krijuar mjedisin ideal në një ballkon: nëse shtoni jastëkë me ngjyrë, efekti do të jetë pothuajse i mrekullueshëm. Mobilie të thjeshta dhe aksesorë që nuk marrin shumë hapësirë: sekret i vërtetë kur vendosni të dekoroni një ballkon është të zgjidhni mobilie me linja të thjeshta që nuk vjedhin shumë hapësirë dhe që madje mund të jenë të palosshme.

Në treg ekzistojnë tani modele me kosto të ulët në natyrë të të gjitha llojeve dhe për të gjitha buxhetet dhe e njëjta gjë vlen edhe për pajisje, të tilla si jastëkë dhe llamba për jashtë. Provojeni që ta besoni!



Vetëm 15 minuta meditim në ditë kanë të njëjtin efekt si një ditë pushimi

Kjo është zbuluar nga një studim i kryer nga Christopher May i Universitetit të Groningenit dhe botuar në 'The Journal of Positive Psychology'. Në të kaluarën, studime të tjera kanë treguar se sa i përket reduktimit të stresit dhe disponimit të shtuar, meditimi ka të njëjtat efekte si një pushim i shkurtër. Ky studim përfshinte 40 të rritur të rinj, të cilëve u është dhënë një CD për të medituar për 15 minuta në ditë për disa javë jo të njëpasnjëshme.

Përveç kësaj, autorët kanë gjurmuar sistematikisht çdo herë që pjesëmarrësit ishin në një pushim nga puna normale e tyre e përditshme dhe detyrime të tjera.

Në këtë mënyrë, studiuesit matën ndikimin relativ të pushimeve dhe meditimit në kushte të tilla si emocionet pozitive ose negative të përjetuara, mirëqenien psikofizike, gjendjen e qetësisë e kuptuar edhe si aftësia për të dëgjuar veten dhe botën rreth (për shembull për të ndaluar në zhurmën e një zogu ose tik-takun e një ore në një dhomë apo edhe në tingujt e një makine që kalon).

"Ne kemi parë se vetëm 15 minuta meditimi shoqërohet me efekte të ngjashme me ato të shkaktuara nga një festë": një vetëdije më e madhe për veten dhe mjedisin, për emocionet pozitive dhe për relaksim, shpjegoi May.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045 82 82 82

FC Prishtina vazhdon përgatitjet për Ligën e Evropës në Pejë

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Tani e tri vjet për përgatitjet për garat ndërkombëtare, Prishtina nuk e ka ndërruar Kosovën. Pas një viti përgatitje në Gjakovë, në dy vjetët e kaluara, sikurse edhe sivjet, FC Prishtina për fazën përgatitore në Evropë zhvendoset në Pejë, më saktësisht në hotelin me kushte ideale, "Onix Spa", të Banjës së Pejës. Skuadra e Prishtinës të mërkurën

ka udhëtuar për Banjë ku do të qëndrojë për dhjetë ditë, ndërsa klubi i është mirënjohës Komunitetit të Pejës e cila edhe një herë i gjendet klubit nga kryeqendra duke i lëshuar fushën e stadiumit "Shahin Haxhiislami" në Pejë. Me skuadrën kanë udhëtuar vetëm futbollistët me kontrata që llogariten se do të vazhdojnë në kampionat për edicionin 2019/20.



FFK-ja organizon kursin e tretë të edukimit Grassroots për trajnere



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) do ta organizojë kursin e tretë të edukimit Grassroots pa pagesë për 24 femra. Kursi do të zgjasë pesë ditë të plota kalendarike dhe do të mbahet nga data 1 deri më 5 korrik. Kursi i edukimit Grassroots do t'i përfshijë këto tema: Njohja bazike e futbollit; Trajning dhe lojëra me fëmijë të moshës 5 deri në 10 vjet; dhe Trajning për të rinj U11-U16. "Kursi është i dizajnuar për trajneret femra të cilat

nuk kanë marrë deri më tani licencë për trajner nga ndonjë federatë e futbollit, si dhe për të gjitha ato që janë të interesuara të fillojnë me punën e trajneres, kryesisht me fëmijët. Kursi kërkon pjesëmarrje në teori dhe praktikë, gjithashtu trajnerët duhet ta përgatisin vetveten fizikisht për këtë kurs", është thënë në njoftimin e FFK-së. Pas përfundimit trajneret do të marrin FFK Grassroots Coach Certificate (UEFA Leaders Certificate).

Dy klube turke në garë për Matan



MANCHESTER, 12 QERSHOR - Futbollisti spanjoll mund të largohet nga Manchester Unitedi në verë. Juan Mata është kthyer në një objektivi të madh për dy skuadrat nga Superliga e Turqisë, Galatasaray e Fenerbahçe. "Daily Mail" raporton që të dyja këto klube janë duke u munduar ta bindin spanjollin të transferohet në Turqi, me Galatasarain që ka një përparësi edhe për faktin që sezonin tjetër luan në Ligën e Kampionëve. "Djajtë e Kuq" i kanë ofruar Matas rinovim të kontratës për një vit shtesë, por ai ende nuk ka vendosur për të ardhmen, pasi është duke i shqyrtuar edhe ofertat e tjera. Nëse nuk merr një vendim për të rinovuar, Mata do të jetë lojtar i lirë që nga 1 korriku.

Perezi paralajmëron rikthim të fuqishëm të Realit

MADRID, 12 QERSHOR - Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, e ka shfrytëzuar prezantimin e sulmuesit të ri, Luka Joviqit, për ta zbuluar projektin e ri ambicioz që dëshiron ta vë në veprim pas dështimit në sezonin 2018/19. Ai ka deklaruar se sezoni i fundit nuk i ka përbushur pritjet. "Ne duam ta zbulojmë para juve fillimin e projektit të ri për sezonin e ardhshëm, bashkë me të gjithë tifozët e Real Madridit. Duhet të

punojmë shumë për ta arritur qëllimin e realizimit të ëndrrave për tifozët tanë", ka thënë Perez. Ai ka paralajmëruar rikthim të fuqishëm të Realit në sezonin e ardhshëm. "Ky nuk ishte viti që po e prisim dhe do të reagojmë fuqishëm dhe në mënyrë vendimtare në kërkim të fiksimit tonë historik, që është fitorja. Ky klub nuk dorëzohet kurrë dhe ne do ta dëshmojmë këtë gjë", ka deklaruar Perez.



Sot zhvillohet finalja e Kupës së Kosovës për veteranët

Prishtinë, 12 qershor (ER) - Sot (e enjte) në stadiumin e 2 Korrikut në Prishtinë në orën 18:00 do të zhvil-

lohet ndeshja finale e Kupës së Kosovës për veteranët, ndërmjet KFV "Mitrovica" dhe KFV

"Ferizaj". Garat e Kupës së Kosovës për veteranët u organizuan sivjet për herë të parë nën ombrellën e

FFK-së, derisa nga edicioni i ri pritet të nisë edhe Liga e Veteranëve.





Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA NË FOTO	BASHKIMI I HARMONISH-EM I DISA TINGUVJE TË NJËKOHSHËM	PJESË E NJË PËLHURE E THYER ME DYSH NË VIJË TË DREJTË (shq.)	MOR, HEJ (pashq.)	KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM	FJALË TINGULLIMIT-UESE (shq.)	RESA, SMIRA	EPOKA ERE	PRINCIPIELE	VEND LUFTIMI I GLADIATORËVE	BARI I THARË	
MONEDHË E VJETËR ARI ME VLERË PREJ NJËZET FRANGASH								PRAPA				
VEGËL MUZIKORE								TOKA E BUKËS POEZIA E DASHURISË				
DETYRË E AKTORIT				KLUB FUTBOLLI NË BELGJIKË SKITAR								
NËPËR ARA, ARAVE					FLOTA DETARE							
IVAN DAKUR				BASHKËT. ROYAL PHOTOGRAPHIC SOCIETY	ERË E MIRË						ARKEOLOGU SKËNDER	
SHTET AZIATIK (pashq.)					TRAJNERI SPANJOLL VILANOVA BASHKËT.					ZANORE KRYEQYTETI KANADEZ		
BASHKËT.		FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN ALEXANDRE ANA FARIS					BENDI MUZIKOR "..... MAIDEN" POLITIKANI FERID					
EPOKA ERE	VEESHJE E SIPËRME E TRASHË	FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO	I PARI I XHAMISË (pashq.)	ZANORE	EPOKA ERE	MUNDËSI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT				KUTIA E VOGËL PREJ KARTONI MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI		
PJESË MUZIKORE PËR TRE INSTRUMENTE OSE PËR TRE ZËRA					HUMORISTI SHQIPTAR ... DEDA BASHKËT.						ARBEN MALAJ DRU I ÇMUESHËM QË PËRDORET PËR ORENDI	
KORNIZË				VEGËL MUZIKORE ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN			REGJISORJA ARZANA VLERA, DOBIA			ISH AKTORJA E FAMSHME GARDNER SHALQI		
I PESHOJ (bised.)					MODELJA AMERIKANE TAYLOR MURI I NDËRTUAR ME DËRRASA		NJERINGR-ËNËS BASKETBOLLISTI OBËRTINCA					
KRYENGRIT-ËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT					BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (sh.pashq.) PËRSËRITËS (gram.)			KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK KADRI ZEKA			ZANORE ROK BEND I YNI	
"OSAKA"			GATESË KUSAR				RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE		OXSIGJEN, NITON ANA RUSO			E PËRZJEVE, E TRAZOVE
EPOKA ERE	KËRCELL I BIMËS SË MISRI	VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT KUNDREJT ABSOLUTE						JO BASHKËTINGËLLORE I PËSHPËRIT DIKUJTI FJALË MAGJIKE				
DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA					SHTETI (fr.) GURRAT					QYTET NË ILIRI I THAJ		
REOMIR, ERBIUM				ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT ARTI I VALLEVE ME FIGURA						BASHKËT. SHTET NË AZI (Pashq.)	JEMENI, ANGOLA VEPËR E KRYER, PUNË	
SHTET FEDERAL NË SHBA						MËRIA, ZILIA BASKETBOLLISTI TURK ONAN				"K" pas dy "A" ARMENIA		
SPIUNIA E FAMSHME ... HARI					GRIMCË MOLEKULARE GAZ PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT			KURESHTJE MODELJA KRASNIQI			ZANORE LUFTËTARI GJERGJ ... ALIA	
AGIM TEJECI			VAJTIM ME LOT RRJETË E TENISIT				QYTET NË KROACI DES MOINES UNIVERSITY			VITI I RI KINEZ (pashq.) "N" pas dy "P"		
BANOR I KINËS					HUMORISTI BAJRAMI NAPOLI, ATALANTA				NDËRMARRJA PRIVATE KALJARI, ATALANTA		LINDA OSAJ RAMADAN AVDIU	
EPOKA ERE	EMËR YNI MASHKULLI BASHKËT.					FSHAT I MADH NË DRENICË TROPOJA				SHKURTOJ, KRASIT DEGËT E NJË PEME		
CIPA MË E BRENDSHME E KOKËRDHOKUT TË SYRIT (sh.shq.)										KAJDE, OJNA		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integritimit Evropian

Ministarstvo Evropske Integracije / Ministry of European Integration

MINISTRIA E INTEGRIMIT EVROPIAN shpallë **KONKURS** për këtë vend të punës:

Titulli i pozitës: Asistent/e Ekzekutive
Numri i referencës: 07/2019/DBF/MIE
Grada e vendit punës: Niveli Profesional 2
Koeficienti: 7

Qëllimi vendit të punës:

- Ofrimi i përkrahjes administrative-teknike dhe profesionale për zyrat e drejtuesve të lartë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

